



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

Nr. 183 prot.

Tepelenë, më 25.01.2024

Lënda: Njoftim për dëgjese publike në kuadër të hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Rruga “Muhamet Gjollësia”, Nr. 57, Tiranë.

Në kuadër të hartimit dhe të miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) për territorin administrativ nën juridiksionin e Bashkisë Tepelenë, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, është duke përditësuar Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 155/2023, datë 13.03.2023 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të lumit Vjosa “Park Kombëtar”, kategoria II”.
Theksojmë se nisma për hartimin e VSM është marrë nga Bashkia Tepelenë në vitin 2018 dhe nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është lëshuar Deklarata Mjedisore për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë.

Në zbatim të Ligjit nr. 91/2013, datë 28.02.2013, Neni 12, Pika 9 dhe sipas kreut “Detyrime dhe sanksione” të deklaratës mjedisore, faqe 5, “*Nëse plani nuk është miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëherë deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para*”.

Për sa më sipër, në zbatim të procedurave dhe afateve të përcaktuara nga Ligjit nr. 91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjësën publike gjatë procesit të VSM”, të ndryshuar, ju njoftojmë se më datë 09.02.2024 do të zhvillohet online dëgjesa e parë publike për çështjet që të trajtohen në raportin e VSM-së.

Aktiviteti do të zhvillohet online në orën 10.00 në adresë Zoom:

<https://us02web.zoom.us/j/6837643188?pwd=MINNOEw4c0RYeUlkN1o3T004ZFB1QT09&omn=82888832262>

Meeting ID: 683 764 3188

Passcode: 5epJ7U

KRYETARI I BASHKISË

Tërmet Peçi

